

## **Çka është puna sociale e shkollës dhe kujt i drejtohet?**

Puna sociale e shkollës është një ofertë për këshillat dhe mbështetjen e nxënseve dhe nxënësve, prindërve, mësuesve dhe shkollës.

**Nxënësit dhe nxënëset** do të marrin ndihmë dhe mbështetje të shpejtë dhe pa komplikime. Për frikën, shqetësimet, polemikën ose pyetje në lidhje me bashkëjetesën ata mundën individualisht (vetëm) ose në grupe ti marrin këshillat tek puna sociale e shkollës. Kjo ka të bëjë me atë që sakt ta shiqojmë situatën dhe së bashku ta kërkojmë zgjidhjen.

**Prindërit** mundën të kontaktojnë me punën sociale të shkollës, nëse janë të brengosur për zhvillimin e fëmijës së tyre ose nëse i shqetëson ndonjë situatë tjetër në shkollë.

Puna sociale e shkollës mund të ndihmojë, të qartësojë, ajo është e njohur me shumë pyetje lidhur me zhvillim dhe shkollim, dhe i njuhë agjencionet profesionale përkatëse.

**Mësuesit** mundën të diskutojnë me punën sociale të shkollës, për situatat të vështira qoftë të një individi apo ndonji grupi. Poashtu problemet do të trajtohen dhe zgjidhen së bashku.

Për tërë shkollën apo për klasët në veçanti mundet puna sociale e shkollës ti inkurajojë apo ti përcjell projektet ose aktivitetet e ndryshme.

## **Si punon puna sociale e shkollës?**

Puna sociale e shkollës është prezente në shkollë, ka orarin e punës të fiksuar apo është e arritshme në telefon. Marrja e kontaktit është e thjeshtë.

Këshilla individuale zakonisht është vullnetare. Një këshillë fillestare mund të iniciohet edhe nga mësuesi.

Oferta është e besueshme (sekrete). Punëtorët ose punëtoret sociale të shkollës janë të obliguar si subjekt ta mbajnë sekretin profesional.

## **Shërbimet janë falas.**

## **Kur mund ti drejtohen prindërit punës sociale të shkollës?**

Nëse ata janë të brengosur për zhvillimin e fëmijës së tyre, ose janë të shqetësuar për ndonjë situatë tjetër.

Më mirë më heret se sa më vonë!

Më mirë njëherë më shumë, se sa një herë më pak!

## **Nuk do të thotë se çdo herë kemi ndonjë krizë (problem) të madhe, nëse edhe puna sociale e shkollës është ftuar të marrë pjesë!**

Për këshilla në gjuhën tuaj keni të drejtë të kërkonit përkthyes.